



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 253, datë 09.07.2020

PËR
RISHIKIMIN E BUXHETIT NË SISTEMIN GJYQËSOR, PËR VITIN 2020, SIPAS
AKTIT NORMATIV NR. 28, DATË 02.7.2020.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, të Ministrit të Financave dhe Aktit Normativ nr.28, datë 02.7.2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020, i ndryshuar”, si dhe me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik dhe Administrimit të Buxhetit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e rishikimit të buxhetit për vitin 2020, në programin e KLGJ-së, 01110 “Planifikim, Menaxhim, Administrim”, duke pakësuar fondet buxhetore në shpenzime personeli (paga- 600), në shumën prej 13,000,000 lekë.
2. Miratimin e rishikimit të buxhetit për vitin 2020, në programin e gjykatave, 03310 “Buxheti i Gjykatave”, duke pakësuar fondet buxhetore në shpenzime personeli në shumën prej 140,000,000 lekë, i ndarë në (paga-600) 128,000,000 lekë dhe (sigurime shoqërore – 601) 12,000,000 lekë. Fondi prej 128,000,000 lekë pakësohet: 48,000,000 lekë në shpenzime për paga (600) të Gjykatës së Lartë dhe 80,000,000 lekë në shpenzime për paga të mbajtura të pashpërndara.
3. Me zbatimin e këtij Vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit,

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR